

«Hyji im, shpresoj në ju»

Në lutje me Nënë M. Elisen

Paraqitje

Shenja e Kryqit

U. Në emër të Atit, e të Birit e të Shpirtit Shenjt.

A. Amen!

Kënga: *Lavdi ty, Jezu Krisht*

*Ref. Jezu Krisht, si dje si sot, Mbreti ynë je për jetë e mot.
Biri i Hyjit, Biri i njeriut, je Shëlbues i botës mbarë.*

Ty të qoftë lavdi, o Qengji i Hyjit,
na bën të pastër me gjakun tënd:
e merr mbi vete fajin tonë.

Vetëm ti na jep shëlbim! Amen! Aleluja! *Ref.*

Ty të qoftë lavdi, në Kishën shenjtë,
je i pranishëm, plot ëmbëlsi,
Zot e Vëlla për çdo njeri.

Vetëm ti na jep shëlbim! Amen! Aleluja! *Ref.*

Ty të qoftë lavdi, për Nënë virgjër,
Nënë hirplote na e dhuron:
lutjen e saj ti e dëgjon.

Vetëm ti na jep shëlbim! Amen! Aleluja! *Ref.*

Ftesë për lutje

L. Të dashur vëllezër dhe motra, jemi mbledhur për të falënderuar Zotin, që ne dhe tërë Kishës na dhuroi Nënë Elisa Andreolin, një grua shprese, virtyt që ka vepruar gjithmonë mbi Shërbëtoreshen e Zotit, duke i dhënë forcë, guxim dhe vendosmëri edhe në situatat më të pafavorshme. I kërkojmë Zotit që, ashtu si Nëna Elisa, të dimë ta vendosim bazën e sigurtë të shpresës sonë në mirësinë e pakufizuar të Zotit.

Lutja

U. Të lutemi.

O Zot Hyj, jeta e besimtarëve të tu, lavdia e të përlururve, lumturia e të drejtëve, dëgjoje lutjen e popullit tënd, dhe me bollëkun e dhuratave tuaja shuaje etjen e atyre që shpresojnë në premtimet tua. Nëpër Krishtin, Zotin tonë.

A. Amen.

I. Shpresa në fatkeqësi

Dëgjimi i Fjalës

L. Nga libri i profetit Isaia

(Is 25,9; 30,18-19)

Dhe do të thuhet po atë ditë: «Ja, ky është Hyji ynë; Në të kemi shpresuar që të na shpëtoje. Ky është Zoti, në të cilin shpresuam; le të gëzojmë, të gadojmë për shpëtimin që na e solli. E pra Zoti pret t'ju përdëllejë, prandaj ngri-tet për t'ju bërë mëshirë, sepse Zoti është Hyj drejtësie; lum ata që shpresojnë në të. Popull i Sionit, që banon në Jerusalem, askurrë më nuk do të qash.

Psalmi

(24,1-5.16.21)

Ref. "O Zot Hyji ynë, e gjithë shpresa jonë është në ty"

(Nënë Elisa Andreoli)

Te ti, o Zot, e lartësoj shpirtin tim!

Hyji im, në ty shpresoj: mos lejo të turpërohem!

Të mos ngihen në mua armiqtë e mi,

dhe askush që shpreson në ty mos u turpëroftë! *Ref.*

Bëj t'i njoh, o Zot, udhët e tua

e m'i mëso shtigjet e tua.

Më drejto me të vërtetën tënde dhe më mëso,

sepse ti je Hyji im, Shëlbuesi im,

në ty shpresoj gjithmonë. *Ref.*

Më shiko, o Zot, e ki dhembje për mua,

sepse jam i vetmuar e i mjerë.

Le të më mbrojnë pafajësia dhe drejtësia,

sepse në ty e kam vënë shpresën. *Ref.*

Leximi

Nga shkrimet e Nënë Elisa Andreolit

Motra ime gjithnjë e dashur motër M. Dolores,

i përgjigjem letrës tënde: 1° Sa më keq shkojnë gjërat me krijesat, pa fajin tonë, aq më shumë kemi besim te Zoti i mirë, sepse ai mbetet i nderuar në besimin tonë vetëm tek ai. Hyji lejon shumë vështirësi të mëdha që të shkëlqejë mirësia e tij: Kur krijesat na premtojnë gjëra të bukura, sa vështirë është që të shpresojmë në Hyjin? [...] Por kur gjithçka është bashkuar kundër nesh dhe ne me përlësi themi me zemër dhe buzë: "Hyji im, besohem në ju, shpresoj te ju, ju dua" këtu është besimi i vërtetë që nderon Hyjin; jo, nuk do të ç'orientohemi! Pra, përpara, guxim, le të besojmë! duke qarë po, por kemi besim.

(Adria, 31 janar 1914)

Thirrje për lutje

U. O Zoti Jezus, përmes mundimeve, Nënë Elisa u rrit në durim dhe në një virtut të provuar, mbështetna edhe ne me hirin tënd.

Ref. *Unë e di se te kush e kam vendosur shpresën time.*

Unë jam e sigurt për dashurinë e tij.

Ai do të më ruajë deri sa të kthehet.

II. Shpresa nuk zhgënjën

Dëgjimi i Fjalës

L. Dëgjojeni Fjalën e Hyjit nga letra e Shën Palit Apostull drejtuar Romakëve (5,3-5)

Ne mburremi edhe për vuajtjet, sepse e dimë mirë se vuajtja sjell qëndresën, qëndresa na bën besnikë të sprovuar e besnikëria e sprovuar sjell shpresën. Shpresa nuk turpëron, sepse dashuria e Hyjit u ndikua në zemrat tona me anë të Shpirtit Shenjt që na u dhurua.

Psalmi (39,2-4)

Ref. *“O Zot Hyji ynë, e gjithë shpresa jonë është në ty”*

Kam shpresuar, kam shpresuar te Zoti,
dhe ai u përkul mbi mua,
ai e dëgjoji britmën time. **Ref.**

Ai më mori nga një pus ujërash të trazuara,
nga balta e kënetës;
ka vendosur këmbët e mia mbi shkëmb,
i bëri të sigurta hapat e mi. **Ref.**

Ai më vuri një këngë të re në gojën time,
një lavdërim për Hyjin tonë.
Shumë do të shohin dhe do të frikësohen
dhe do të besojnë te Zoti. **Ref.**

Leximi

L. Nga shkrimet e Nënë Elisa Andreolit

Marr letrën tënde dhe përgjigjem: “Qaj, gjëmo para Jezusit, por gjithnjë duke përsëritur: “Zemra e Jezusit dhe e Marisë, kam besim te Ju!” Kurrë askush që shpresoi në Jezusin dhe Marinë e tejet të Shenjtë, mbeti i zhgënjyer. Pra, as Motër Dolores nuk do të jetë e para! Sa më shumë që krijesat të thonë jo, aq më shumë shpresojmë në Hyjin! Me një frymë, Hyji fiton mbi të gjithë, shpërndan të gjithë. Kurajo! Kur Shkëlqesia e tij ose dikush tjetër, do të vijë të flasë me mua, unë do t'i shkruaj ... Mjaft! Vetëm Hyji di gjithçka; Vetëm Hyji do ta rregullojë. *Deus Veritas; homo mendax!*”.

(Adria, 7 shkurt 1914)

Thirrje për lutje

U. O Zoti Jezus, Nënë Elisa e dëshmoi besim në mirësinë dhe sigurinë e ndihmës tënde, dhurona edhe ne këtë besim që të jemi njerëz të paqes dhe shpresës.

Ref. *Unë e di se te kush e kam vendosur shpresën time.*

III. Të shpëtuar në shpresë

Dëgjimi i Fjalës

L. Dëgjojeni Fjalën e Hyjit nga letra e Shën Palit Apostull drejtuar Romakëve (8,22-25)

Mbarë krijesa gjëmon dhe vuan në dhimbjet e lindjes deri tani. Dhe jo vetëm ajo! por, gjithashtu edhe ne, që kemi frytet e para të Shpirtit Shenjt, gjëmojmë në vetvete, duke pritur adoptimin shpërblimin e trupit tonë. Vërtet, kemi qenë shëlbuar, por në shpresë. Porse shpresa që shihet, nuk është shpresë. Sepse, çka dikush e sheh, si mund ta shpresojë? Nëse, pra, shpresojmë çka nuk shohim, atë gjë e presim me qëndresë.

Psalmi (61,6-9)

Ref. *“O Zot Hyji ynë, e gjithë shpresa jonë është në ty”*

Vetëm në Hyjin pusho, o shpirti im,
vetëm në të qëndron shpresa ime!
Vërtet vetëm Ai është Hyji im e shpëtimi im,
kështjella ime: kurrë më nuk do të trandem! **Ref.**

Në Hyjin është shëlbimi im e nderi im,
në Hyjin shpresa e fuqisë sime, strehimi im në Hyjin. **Ref.**

Shpreso në të gjithmonë, o popull,
atij hapi zemrën,
sepse Hyji është strehimi ynë. **Ref.**

Leximi

L. Nga shkrimet e Nënë Elisa Andreolit

Më shkruajnë nga Adria që të mos mendoj se e fitoj çështjen, sepse masoneria është e fuqishme. Protestoj se për këtë shpresoj edhe më shumë, sepse të shpresosh në Hyjin në raste të dëshpëruara e lavdëron jashtëzakonisht mirësinë e tij.

(*Archenda*, 1910)

Thirrje për lutje

U. O Zoti Jezus, me gjithë krijimin presim lavdinë e bijve të Hyjit, na ndihmo që të jetojmë me këtë shpresë, falë Shpirtit të Shenjtë, që na është dhuruar.

Ref. *Unë e di se te kush e kam vendosur shpresën time.*

IV. Shpresa vetëm në Hyjin

Dëgjimi i Fjalës

L. Dëgjojeni Fjalën e Zotit nga letra drejtuar Hebrenjve (6,17-20)

Kështu edhe Hyji: duke dashur t'ua vërtetojë në mënyrë më të plotë trashëgimtarëve të premtimeve palëkundshmërinë e vendimit të vullnetit të vet, u bë dorëzanë me përбетim. Në këtë mënyrë, në fuqi të dy veprimeve të

patjetërsueshme - në të cilat është e pamundur që Hyji të gënjejë - ne, që u strehuam në Hyjin, jemi shumë të nxitur të mbështetemi në shpresën që na u parashtrua. Atë e kemi spirancë të sigurt dhe të fortë për jetën tonë.

Psalmi (150,1-6)

Ref. “O Zot Hyji ynë, e gjithë shpresa jonë është në ty”

Lavdërojeni Hyjin në shenjtëroren e tij,
lavdërojeni atë në fortesën e tij madhështore.

Lëvdojeni për veprat e tij,
lavdërojeni atë për madhësinë e tij të pamasë. **Ref.**

Lavdërojeni me zërin e birit,
lavdërojeni atë me harpë dhe cetër.

Lavdërojeni me dajre dhe valle,
lëvdojeni në korda e me fyej. **Ref.**

Lëvdojeni me cimbele tingëlluese,
lavdërojeni atë me cembale kumbimi.
Çdo gjallesë le t'i jepë lavdi Zotit. **Ref.**

Leximi

L. Nga shkrimet e Nënë Elisa Andreolit

Virtyti i shpresës për shpëtimin e tij të përjetshëm ishte i palëkundshëm në Nënë Elisen, por gjithnjë duke pasur parasysh meritat e Jezu Krishtit. Këtë virtyt e përcolli te bijat e saj, duke i rekomanduar ato për të mos e mbështetur shpresën në krijesa që të mos mbeten të zhgënjyera, por vetëm te Zoti. Në fakt, kur, në momentet më të vështira për Institutin e saj, i ofroheshin njerëz të e mirë, për ta ndihmuar, me mirësjellje thoshte se nuk kishte nevojë, sepse Burri i saj mendonte për gjithçka. Ajo do të thoshte, bashkëshorti i tejetshenjtë Jezu Krishti.

(*Dëshmia* e motër M. A. C.)

Thirrje për lutje

U. O Zot Jezus, Nënë Elisa na ka ftuar të braktisim në ty çdo vështirësi dhe shqetësim, përtërije zemrën tonë në mënyrë që të dhurohemi me bujari, të sigurt se vetëm shpërblimi yt vlen.

Ref. *Unë e di se te kush e kam vendosur shpresën time.*

V. Nga shpresa në Hyjin kënga e lavdërimit

Shpallja e Ungjillit

(*Ungjilli mundet që të shpallet midis kronistit, lexuesit = Eliza-beta dhe korit = Maria*)

L. Dëgjojeni Fjalën e Zotit nga Ungjilli sipas Lukës
(1,41b-42a.45-48)

Elizabeta u mbush me Shpirtin Shenjt dhe brohoriti me zë të lartë: «E lumja ti që besove se do të plotësohet çka të qe thënë prej Zotit!».

Atëherë Maria tha: «Shpirti im e madhëron Zotin, shpirti im me hare i brohorit Hyjit, Shëlbuesit tim, sepse shikoi me pëlqim mbi shërbëtoren e vet të përvuajtur. Ja, që tani të gjitha breznitë do të më quajnë të lumtur».

Shpallja e Ungjillit mund të pasohet nga një reflektim nga personi që kryeson ose mundet të lexohet një tekst nga Magisteriumi: për shembull nga leximi i enciklikës Spe Salvi nga Benedikti XVI, n. 2.

Lutja ndërmjetësuese

U. E lavdërojmë Shpëtimtarin, që na dhuron shpresë e paqe dhe së bashku lutemi me besim:

A. O Hyji, Ati ynë,
ti i ke dhënë Kishës sate
Nënë Elisa Andreolin
që në jetën e saj ka kërkuar vazhdimisht,
duke u frymëzuar te Virgjëra, për të kuptuar planet
e dashurisë tënde të mëshirshme
dhe të përmbushë vullnetin tënd.

Ne të falënderojmë
për këtë dhuratë dashamirëse dhe të lutemi:
na jep hirësinë, që sipas shembullit të kësaj shërbëtores
sate besnike,
ta duam dhe t'i shërbejmë planit tënd të shpëtimit
dhe të dashurisë për të gjithë njerëzit;
denjohu që ta lavdërosh mbi këtë tokë;
na dhuro hirin që me besim po presim...

*Një hapësirë e shkurtër heshtjeje, në mënyrë që secili të formulojë,
brenda zemrës së vet, hirin që dëshiron të kërkojë.*

Ati ynë

Lutja

U. Të lutemi.

O Atë, shiko me mirësi bijtë e tu që besojnë në ndihmën tënde: bëj që ndër provat e jetës asnjë lutje të mos mbetet e padëgjuar, asnjë shpresë të mbetet e zhgënjyer, dhe së bashku me shenjtën Mari, Nënë e shpresës, të mund të marrim pjesë në dashurinë tënde të përjetshme. Nëpër Krishtin, Zotin tonë.

A. Amen.

Përfundimi

Shpërndarja

U. Le të shkojmë në paqe, duke ruajtur në zemër shpresën që nuk zhgënjën.

A. Falënderojmë Hyjin.

Kënga: “Bontà” e Shërbëtorëve të Marisë

Ose një këngë tjetër e përshtatur dhe e njohur nga asamblea.

A cura della Postulazione SMR
postulazione@smr.it